

VENDIM
Nr. 367, datë 18.4.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 678, DATË 18.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR KTHIMIN NË FOND BANESASH TË DISA OBJEKTEVE TË ISH-KOMBINATIT TË
TEKSTILEVE TË PAMBUKTA, NË TIRANË, TË NDËRMARRJES MEKANIKE-TEKSTILI,
TIRANË DHE TË ISH-SHKOLLËS SË PARTISË, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 678, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:
“2. Enti Kombëtar i Banesave të bëjë kalimin në pronësi, pa kundërshpërblim, të këtyre objekteve, për personat, të cilët i kanë aktualisht në përdorim.”.
 2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave, Njësia Bashkiake nr. 11, Tiranë, dhe ish-Kombinati i Tekstileve të Pambukta, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha